



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:101490
Datë: 17.10.2023
Numri i dokumentit: 04794414
P.nr.1362/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Dibran Jusufi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Sadete Kuqi Berisha, në çështjen penale kundër të pandehurit G.K. për shkak të veprës penale kanosja nga neni 185 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.II.4329/2017 të datës 12.03.2018, duke vepruar sipas detyrës zyrtare dhe jashtë seance me datën 17.10.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET poshtë aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë me numër PP.II.4329/2017, e datës 12.03.2018 dhe PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit G.K. për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 185 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së ngase tanimë kjo vepër penale është përfshirë në parashkrimin relativ të ndjekjes penale.
- II. Të dëmtuarit B.N. dhe I.I. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.
- III. Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm me datë 20.03.2023 pranë kësaj gjykate ka dorëzuar aktakuzën me numër PP.II.nr.1756/2022 të datës 12.03.2018, kundër të pandehurit G.K. për shkak të veprës penale kanosja nga neni 185 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Gjyqtari i çështjes me këtë lëndë është ngarkuar me datë 04.09.2023, me ç'rast duke vepruar sipas detyrës ka bërë shikim dhe analizimin e shkresave të lëndës me ç'rast ka gjetur se vepra penale për të cilën është akuzuar i pandehuri përfshirë në parashkrimin relativ të ndjekjes penale ngase vepra penale d Kanosja nga neni 185 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së numër 04/L-082, është e dënueshme prej 6 muajve e deri në 3 (tri) vite me burgim ndërsa bazuar në nenin 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së numër 04/L-082 sipas të cilit thuhet se *“ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë pesë (5) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se tre (3) vjet burgim”*, ndërsa nga shkresat e lëndës rezulton se aktakuza është ngritur në këtë gjykatë me datë 20.03.2018 e që deri më tani kanë kaluar mbi 5 (pesë) vite ndërsa në anën tjetër rezulton se nuk është ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të ndjekjes penale, gjykata erdhi në përfundim ndaj të pandehurit të lartcekur duhet të hedhet aktakuza dhe të pushohet procedura penale ngase vepra penale për të cilën është akuzuar i pandehuri tanimë është përfshirë në parashkrimin relativ të ndjekjes penale.

Gjykata sipas detyrës zyrtare dhe konform nenit 107 paragrafi 6 të KPRK-së ku është përcaktuar se *“Afatit i parashkrimit po ashtu ndërpritet kur kryesi para skadimit të afatit të parashkrimit kryen një vepër tjetër penale me peshë të njëjtë ose më të rëndë se sa vepra penale e mëparshme”*, me ç'rast nga të dhënat e gjykatës ka gjetur se i pandehuri gjatë kësaj kohe nuk ka kryer ndonjë vepër tjetër penale, si kusht për ndërprerjen e afatit të parashkrimit.

Nga të lartcekurat dhe në bazë të nenit 106 paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 të KPRK-ës dhe nenit 357 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të KPP-ës është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.1362/183, me datë 17.10.2023

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Dibran Jusufi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë brenda afatit prej 3 (tri) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit, e nëpërmjet të kësaj Gjykate.